

❖ PESHORE BLETESH TELEMETRIKE
.....MZ-2630 (GPS) ...V.3.0.....



MELISSOZIGARIA

Manual perdonimi

Tabela e permajtjes

Shpjegim i detajuar dhe rregullim i parametrave te mesazheve (sms).....	3
Parametrat e mesazheve.....	4
PARAMETRAT	5
Hapa te detajuar.....	9
Vendosja e telefonave per te derguar mesazhe raportimi	10
Percakto ditet per mesazhet e raportimit (SMSDAYS)	10
Percaktimi i oreve te mesazheve te raportimit (SMSHOURS)	11
Sinkronizimi i dates dhe ores – (E RENDESHISHME)	11
Komanda report dhe thirrjet e pajisjes	12
Gjendja private	13
Kontrolloni parametrat e ruajtur te pajisjes (komanda PARAMS)	13
Komanda Get.....	13
Gjendja e gjumit.	13
Funksioni (Gjendja) Auto-Sleep	15
Komanda Reset.....	15
Komanda Location.....	15
Komanda DIFF.....	16
Peshimi	16
Voltazhi i brendshem i baterise (BAT)	16
Paneli diellor	17
Alarm – Tamper1, Tamper 2.....	17
Vendodhja e pajisjes (zona gjeografike).....	18
Sirena.....	18
Fence	19
Sinjali Gsm (sinjali i kompanise telefonike) & antena e jashtme (Extra)	19
Karrikimi i baterise.....	20
LEDS	20
Ruajtja (paketimi) e pajisjes	21
Lista finale e kontrollit – shenime	21
Shpjegimi i tingujve nga pajisja :	22
Shenime	23
Kontakte	23

Ne vendosim ne pajisje nje karte SIM (Te llojit te vogel "Mini") me "PIN" te caktivizuar .

Vendosim pajisjen ne gjendjen e deshiruar zgjuar "SLEEP OFF" ose ne gjendje gjumi (SLEEP ON) pajisja dergon mesazhe sipas "oreve te mesazheve"

* **gjendja aktuale e pajisjes eshte e zgjuar " SLEEP OFF."**

Me te perfunduar vendosjen e shkalleve (masave) vendoseni pajisjen ne gjendje gjumi duke shkruar:

1234 SET SLEEP ON 1234 SET SLEEP OFF

Shpjegim i detajuar dhe rregullim i parametrave te mesazheve (sms)

Z1: 0-120KG (+100gr)	(pesha e peshes 1) (Diferenca)
Z2: 0-120KG (+100gr)	(pesha e peshes 2) (Diferenca)
Z3: 0-120KG (+100gr)	(pesha e peshes 3) (Diferenca)
TEMP_IN -55°C +125°C	(temperatura e brendshme e zgjoit)
TEMP: -40°C +80°C	(temperatura e ambjentit)
HUM: 0-100%	(Lageshtia e ambjentit)
FENCE: 0-15KV	(shkarkimi i tensionit elektrik)
BAT: 3.7-4.3 V	(Bateria 3.70V=0% - 4.21V=100%)
GSM: 0-100%	(kualiteti , cilesia e sinjalit GSM)
LOW BAT	(voltazhi i baterise nen 3.60V)

Parametrat e mesazheve

PHONE1: **691111111111**(numri i pare i telefonit i autorizuar)

PHONE2: **6912341234**(numri i dyte i telefonit i autorizuar)

PHONE2STATE:OFF-ON(numri i dyte i autorizuar “OFF”e caktivizuar “ON” e aktivizuar)

LL: **0-5.000**Limit i ulet voltazhi i shkarkimit elektrik

TAMPER1: **OFF - ON**(*OFF=E CAKTIVIZUAR* *ON=E AKTIVIZUAR*) **ZONE 1**

TAMPER2: **OFF - ON**(*OFF=E CAKTIVIZUAR* *ON=E AKTIVIZUAR*) **ZONE 2**

FENCE: **OFF - ON**(*OFF=E CAKTIVIZUAR* *ON=E AKTIVIZUAR*)

GEOFENCE OFF-ON(*MONITORIMI I GEOFENCE*)

PRIVATE: **OFF - ON**(*OFF=CAKTIVIZUAR PUPLIC* *ON=E AKTIVIZUAR= NON PUPLIC*)

PCB_TMP(*TEMPERATURA E PAJISJES*)

PESHORE BLETESH TELEMETRIKEMZ-2630 (GPS)

PARAMETRAT

SHKRIMI I MESAZHIT

<PASS><SPACE><COMMAND><SPACE><VALUE>(1234 SETPHONE1 699000000)
<pasuordi><apesire><komanda><,apesire><vlera> (1234 setPHONE1 699000000)

PASUORDI I PAJISJES ESHTE „1234“

Komanda e mesazhit	Vlera	Pershkrimi
1234 SET PHONE1	69*****	Percaktohet nr i pare i telefonit qe do ti dergohen sms
1234 SET PHONE2	69*****	Percaktohet nr i dyte i telefonit qe do ti dergohen mesazhe
1234 SET PHONE2STATE	ON	Aktivizon nr e dyte per ti derguar mesazhe
1234 SET PHONE2STATE	OFF	Caktivizon nr e dyte per ti derguar mesazhe
1234 SET FENCE	ON	Aktivizon monitorimin e shkarkimit elektrik
1234 SET FENCE	OFF	Caktivizon monitorimin e shkarkimit elektrik
1234 SET LOWLIMIT	0-5000	Vendosim limitin minimal ne volt per te dergua mesazhe dhe thirrje

1234 SET TAMPER1	ON	Aktivizon monitorimin e zone1
1234 SET TAMPER1	OFF	Caktivizon monitorimin e zone1
1234 SET TAMPER2	ON	Aktivizon monitorimin e zone2
1234 SET TAMPER2	OFF	Caktivizon monitorimin zone2
1234 SET TAMPERS	ON	Aktivizon monitorimin e zone1 dhe zone2
1234 SET TAMPERS	OFF	Caktivizon monitorimin e zone1 dhe zone2
1234 SET ALARMS	ON	Aktivizon monitorimin e rregulatorit dhe zone1 dhe zone2
1234 SET ALARMS	OFF	Caktivizon monitorimin e rregulatorit dhe zone1 dhe zone2
		Ndryshim pasuordi (kodi)
1234 SET PASS	0000-9999	Duhet te vendosen maksimumi 4 numra si ne shembull
		Psh.1234 SET PASS 4321
1234 SET PRIVATE	ON	(ON)=pajisja nuk eshte publike.dergon mesazhe te nr 1 dhe nr 2 i telefonit vetem
1234 SET PRIVATE	OFF	
1234 PARAMS		Dergon te gjitha parametrat e ruajtur te pajisjes
1234 RESET		Ristarton pajisjen (fik dhe ndez automatikisht pajisjen)

1234 LOCATION		Dergon vendodhjen e pajisjen duke perdorur google maps location .
1234 SET GEOFENCE	ON-OFF	Aktivizon ose caktivizon rrezen e monitorimit (vendodhjen gjeografike). kycja e pikes behet me venien ne pune te pajisjes.
1234 SET GEORADIUS	1000	Percaktojme rrezen (vendodhjen gjeografike) e pajisjes ne meter. Rekomandohet rreze 1000m
1234 SET SLEEP	ON-OFF	Vendos pajisjen ne gjume ose jo. Ne gjendje gjumi eshte e aksesueshme vetem gjate kohes se korrespondimit "oreve te mesazheve" ("smshours") per 3 minuta. Ne gjendjen e zgjuar eshte e aksesusmve per 24 oret ne dite
1234 SET SMSHOURS	ALL 00#01#02#20#22etc	ALL per te gjitha oret.per te derguar nje mesazh psh ne oren 22:00 eg. 1234 SET SMSHOURS 22 (eshte e percaktuar per cdo dite ne oren 22:00)
1234 SET SMSDAYS	ALL Cdo dite	Percaktojme dittet qe do te dergohen mesazhe 1234 SET SMSDAYS ALL 1234 SET SMSDAYS MO#TU#WE#TH#FR#SA#SU Ora e percaktuar eshte 22:00

1234 SET DATE	01/05/17#09:05	Percaktojme daten dhe ora(shkallet e gps kane rregullim kohe satelitore automatik). Ne sinkronizim dergohet mesazh : "ora eshte sinkronizuar"(TIME IS SYNCHRONIZED.) nqse ora nuk eshte vendosur si pasoje e sinjalit te dobet te GPS, pajisja nuk kthehet ne gjendje gjumi ne\qse eshte perzgjedhur gjendja e gjumit (sleep on), ne kete rast duhet bere sinkronizim manualisht me komandat e meposhtme :
		1234 SET DATE 01/05/17#09:05
1234 SET TIMEZONE	+2.0	Zona e ores per Greqine (Nje ore me Greqine) (+2.0)
1234 SET DST	ON-OFF	Ndryshim automatikisht i ores dimerore dhe verore kur eshte e percaktuar ON
1234 SET DIFF	ON-OFF	Gjendje e tregimit se differences se peshes krahasuar me raportimin e meparshem (e rregulluar paraprakisht dergon vetem mesazh) pajisja e ka te qe ne prodhim gjendjen ON
1234 REPORT		Dergon mesazhin e raportimit
1234 GET	Command	etc1234 GET DATE e vlefshme per cdo komand
1234 SET AUTOSLEEP	ON-OFF	Funksioni i gjumit te thelle. Aktivizohet nqse eshte lidhur me pajisjen ndonje panel diellor per e shmangur fikjen totale te pajisjes.

Hapa te detajuar

Pajisja ne duart tuaja eshte e paraqitur nga ne dhe ju nuk keni nevoje te beni asnjë ndryshim ne parametrat e saj vetem qëse doni dicka te vecante nga parametrat aktual te pajisjes.

1. Duhet te keni një kart SIM mini nga cdo lloj kompanie telefonike sipas deshires
2. Sigurohuni qe eshte caktivizuar kodi PIN i kartes SIM
3. Opsion : disa karta Sim duhet te aktivizohen duke bere si fillim një thirrje dalese , per te qene i sigurt beni një telefonate per ta testuar
4. Eshte mire te aktivizoni një pakete mesazhesh nga operatori telefonik qe do te zgjidhni .
 - Eshte ide e mire te krijoni një llogari online per numrin e telefonit qe do te perdorni per te pasur mundesi ta kontrolloni dhe menaxhoni ne distance
5. Vendosni karten SIM ne pllaken ame , duke ngritur mbajtesen me sensoret prej bakri te kartes te jene nga poshte. Pastaj vendos karten SIM ne vendin e caktuar.
6. Perpara se te perdorni peshoren, sigurohuni qe eshte e karrikuar plotesisht dhe qe llampa e karrikimit (CHG) eshte e fikur
7. Lidh sensoret me pjesen kryesore. Duhet te jeni te kujdeshem shume ne kete hap qe te mos demtohen konektoret. Rrotullojeni lehte derisa te futet plotesisht.
8. Mbani mend se pajisja eshte e parqitur nga prodhuesi me numrin tuaj , si numer primar per te derquar mesazhe , dhe nuk duhet te beni asgje absolutisht.
9. Per alternim, te gjitha parametrat mund te ndryshohen inepermjet telefonit tuaj celular thjesht duke derquar një mesazh numrit te telefonit qe keni vendosur ne pajisje.

Pasuordi i vendosur ne prodhim eshte : 1234

Per cdo modifikim ne parametrat e peshores perdon kordin e vendosur 1234.
Nqse doni te ndryshoni kordin fillestar ne një kod te ri sipas pelqimit tuaj,
dergoni mesazhin e meposhtem kordin e vjeter (dmth. 1234) , hapesire, SET
PASS, hapesire , (shkruaj kordin e ri 4 shifron)

Mesazhi qe do shkruhet :**1234 SET PASS 5678**

Peshorja do te dergoje nje per gjigje me kodin e ri qe keni vendosur, keshtu qe te gjitha komandat do te behen me kodin e ri qe keni vendosur.

E rendesishme :kodi duhet te kete maksimumi 4 karaktere (vetem numra mund te perdoren)

Vendosja e telefonave per te derguar mesazhe raportimi

Numri maksimal i telefonave te cileve pajisja mund tju dergoj mesazhe eshte 2 cope.
(Phone1 & Phone2)

Per te vendosur numrin e pare /kryesor dego mesazh me tekst peshores:

1234 SET PHONE1 6911111111

Nqse doni te merrni mesazhe raportimi ne nje numer te dyte telefoni gjithashtu , duhet te dergoni nje tekst peshores:

1234 SET PHONE2 6922222222

Gjithashtu nevojitet te aktivizosh numrin sekondar duke derguar peseri mesazh ne peshore me tekstin e meposhtem :

1234 SET PHONE2STATE ON

Ne te njejin kontekst nqse do ta caktivizosh shkruan tekstin e meposhtem:

1234 SET PHONE2STATE OFF

Percakto ditet per mesazhet e raportimit (SMSDAYS)

Mund te percaktosh ditet qe deshiron te te vijne mesazhe raportimi . pajisja eshte e parapercaktuar te dergoje mesazhe raportimi cdo dite.

Per shembull nqse deshiron te marresh mesazhe cdo dite te javes shkruaj mesazhin:

1234 SET SMSDAYS ALL

Ose

1234 SET SMSDAYS MO#TU#WE#TH#FR#SA#SU

Shembull per te marre mesazhe vetem per dy dite te javes (e hene dhe e premte)

1234 SET SMSDAYS MO#FR

I njejti koncept aplikohet pet cdo numer ditesh qe doni te vendllohi.

Percaktimi i oreve te mesazheve te raportimit (SMSHOURS)

Mund te zgjedhesh core te dites deshiron te te vijne mesazhe raportimi nga peshorja.

Ora e percaktuar paraprakisht ne peshore eshte ora 22:00.

Per shembull per marrjen e mesazheve per cdo ore te dites shkruhet teksti :

1234 SET SMSHOURS ALL

Ose

**1234 SET SMSHOURS 00#01#02#03#04#05#06#07#08#09#10.... Etj (gjithmone
ndermjet numrave vendllohi #)**

Per shembull per te derguar mesazhin e raportimit ne oren 8:00dhe 20:00:

1234 SET SMSHOURS 08#20

(oret gjithmone shkruhen me dy numra dhe me # ne mes)

I njejti koncept perdoret per te gjitha oret e gjithe qe do te zgjidhni

Sinkronizimi i dates dhe ores – (E RENDESHME)

Jepini vemendje ketij hapi pasi eshte me rendesi vitale

Gps i peshores sinkronizon oren automatikisht nepermjet satelitit.

Nqse do te besh prove fillimisht me pajisjen, si fillim vendose pajisjen jashte ne fushe, sigurohuni qe ta beni proven jashte (pasi ne ambjentet e brendshme nuk ka sinjal satelitor te mjaftueshem)

Sikronizimi i ores mund te varioje nga kualitetit i marrjes se sinjalit dhe mund te doje 5 deri ne 120 minuta ose me shume.

Neqoftese pajisje per cdo lloj arsyeye nuk ben sinkronizimin, peshorja nuk do te punoje saktesisht me oret.

Negoftese sinkronizimi nuk ndodh, kerkohet sinkronizim manualisht .

Per ta bere kete shkruani tekstin e me poshtem:

**1234 SET DATE 01/02/18 #02:05 (gjithmone shkruajme oren me dy shifra psh. 01 ,
02 etj)**

Ju do te merrni nje mesazh informal qe konfirmon nderrimin e suksesshem te ores sepse do tju tregojte ore e ndryshuar qe keni vendosur (NEW DATE...)

Mund te ndryshosh gjithashtu parametrat (DST) per nderrimin automatikisht te ores dimerore dhe verore (-+ 1 ore). Parametri i vendosur fillimisht ne pajisje eshte ON dhe ju nuk keni perse ta ndryshoni.

Neqoftse deshironi ta ndryshoni duhet te shkruani tekstin :

1234 SET DST ON-OFF

Zona e ores nuk ka perse te ndryshohet pasi eshte vendosur prej nesh ne +2ore

Nese per cdo lloj arsyeye pajisja fiket atehere ora eshte e heqr. Ne rast te nje risetimi koha ngelet.

Komanda report dhe thirrjet e pajisjes

Duke derguar mesazhin :**1234 REPORT**

Peshorja do te dergoje nje mesazh informues me peshen, temperaturen etj aktuale.

Gjithashtu mund ta telefonosh (therrasesh) pajisjen ne vend qe ti dergosh mesazh. Ne kete menyre pajisja do ta refuzoje thirrjen, per tju shmangur cdo ngarkese te panevojshme dhe do dergoj nje mesazh te shkruar me te njejtat statistika si me lart. Koha e pergjigjes eshte afersisht 1-3 minuta.

Gjendja private

Kur gjendja private eshte OFF, cdokush qe telefonon pajisjen do te marri nje tekst raportimi me peshen, informacionin etj.

Nga ana tjeter, kur gjendja private eshte ON pajisja injoron cdo tlefonate , thirrje pervec atyre te dy zoterueseve dmth nr 1 dhe nr 2 qe jane percaktuar ne fillim.
(Phone 1&2)

Kontrolloni parametrat e ruajtur te pajisjes (komanda PARAMS)

Per te marre mesazh me te gjitha parametrat e ruajtur te pajisjes shkruani tekstin:

1234 PARAMS

Komanda Get

Neqoftese do te shohesh statusin e nje parametri individual (psh. Data, alarm 1, alarm 2) shkruaj :

1234 GET DATE

1234 GET TAMPER1

1234 GET TAMPER2

Kjo aplikohet per cdo komande.

Gjendja e gjumit.

Ka dy gjendje kryesore ne te cilat kjo pajisje mund te veproje: gjendja e gjumit dhe gjendja e zgjuar.

Duhet te zgjedhni mecilen nga te dyja gjendjet doni te veproje pajisja.

Gjendja fillestare e pajisjes eshte :OFF

Per te aktivizuar gjendjen e gjumit dergoni tekstin :

1234 SET SLEEP ON

Kur gjendja e gjumit eshte e aktivizuar pajisja zgjohet vetem ne oret dhe ne ditet qe ne kemi caktuar (smsdays & smshours) per te derguar mesazhet e zakonshme te raportimit.

Pajisja do te jete e disponueshme per 3 minuta ne ditet dhe ne oret qe kemi caktuar, keshtu qe cdo ndryshm qe deshironi te beni duhet te behen ne kete kohezgjatje. Te gjitha oret e tjera peshorja do te je te e padisponueshme pasi eshte ne gjendje gjumi .

Nje menyre e thjeshte per te bere ndryshime kur peshorja eshte ne gjendje gjumi eshte te presim per ardhjen e mesazhit te paracaktuar dhe menjehere pas tij ti japim komanden e deshiruar.

Mos dergoni disa mesazhe njeheresh sepse ne nuk japim siguri neqoftese keto mesazhe do te shkojne (kjo varet nga kompania telefonike e zgjedhur). Kompanite telefonike mund te ruajne mesazhe per ti derguar ato me pas brenda 7 diteve.

Nese dergon shume mesazhe nuk mund te jesh i sigurt cili mesazh do te arrij i pari ,keshtu qe eshte e mundur qe te ngaterrohen parametrat e pajisjes.

Neqoftse deshironi te dergoni disa komanda njeheresh , rekomandohet te caktivizohet gjendja e gjumit fillmisht dhe me pas te behen te gjitha ndryshimet. Pas kesaj mund te aktivizoni gjendjen e gjumit .

Per te caktivizar gjendjen e gjumit duhet te dergoni me mesazh tekstin :

1234 SET SLEEP OFF

Kur pajisja eshte ne gjendje gjumi , eshte gjithashtu ne gjendje maksimale te ruajtjes se energjise.

*mbikqyrja e hapesires se pajisjen nuk eshte e mundur ne gjendjen e gjumit

**nese ndodh ndonje nderhyrje ne zonen e alarmit njoftimi nuk do te vije menjehere por do te vij ne oren e percaktuar per marjen e mesazheve “smshour”*

**neqoftese deshironi qe peshorja te funksionoje plotesisht dhe te jete e arritshme dhe e aksesueshme ne te gjithe kohen, duhet te caktivizioni gjendjen e gjumit. Duke bere kete do tju duhet gjithashtu nje burim energjie konstant i lidhur me peshoren.*

Funksioni (Gjendja) Auto-Sleep

Neqoftese e keni blere pajisjen pas dates 15/6/18 atehere peshorja juaj e suporton kete vecori. Nese jo, atehere pajisja juaj ka nevoje te permiresohet me versionin me te fundit te software .

Kur komanda eshte e aktivizuar, pajisja juaj monitoron nivelin e voltazhit te baterise dhe kur bie nen limitin e sigurise se percaktuar (3.45V), peshorja automatikisht do te ndryshoj gjendje dhe do te bjere ne gjume te thelle.

Ne gjume te thelle, te gjitha elementet e pajisjes jane fikur per te kursyer bateri ne maksimum. Te gjitha elementet do te ndizen perseri automatikisht kur voltazhi i baterise te jete mbi minimumin e limitit te percaktuar (3.75V).

Ne kete menyre , pajisja nuk rrezikon te fiket totalisht , ne rast se kjo ndodh atehere duhet nje venie ne pune nga e para manualisht.

Ky funksion eshte ideal kur peshorja perdoret me nje panel diellor.

Per te aktivizuar kete vecori, shkruaj tekstin e meposhtem ne mesazh:

1234 SET AUTOSLEEP ON

Komanda Reset

Kjo komande sherben per te rivene (ristartuar) peshoren.

Per te rivene ne gjendjen fillestare ne pune peshoren shkruajme emsazhin me tekst:

1234 RESET

Ne rast keqfunkcionimi te pajisjes ose nevojes per te ripercaktuar vendndodhjen (lokacionin) e zones gjeografike te sistemit , keshillohet nje ristartim, rivenie ne pune.

Komanda Location

Duke shkruar mesazhin :**1234 LOCATION**

Mund te ndryshosh vendodhjen aktuale te peshores

* vendndodhja (lokacioni) nuk eshte i disponueshem kur peshorja eshte ne gjendje gjumi .

Komanda DIFF

Kur komanda DIFF eshte e aktivizuar pajisja do te dergoje gjithashtu mesazh per diferencat ne peshe ndermjet peshes se gjendjes aktuale dhe gjendjes se meparshme te planifikuar.

Kjo komande eshte e vendosur fillimi si : **ON**

Neqoftse deshiron ta aktivizosh ose caktivizosh kete komand shkruaj me mesazh tekstin :

1234 SET ON OR 1234 SET OFF

Ne rast se therret (telefonon) peshoren, ne vend qe ti dergosh mesazh, mesazhi informal do te permbate diferenca e peshes ndermjet peshes momentale dhe asaj te matjes se meparshme te planifikuar.

Shfuqizimi i diferenca se peshes ndodh vetem ne oret e planikuara per marrjen e mesazheve (smshour).

Peshimi

Peshorja funksionon me nje algoritem te brendshem balancim-peshe per te korrigjuar cdo devijim per faktore mjedisi (si psh era , pjerresia etj). Keshtu qe nese e vendosni objektin per peshim do tju dergoj mesazhin me nje vonese prej 5 minutash.

Koha e dergimit te mesazheve nga ristartimi/ rivenie ne funksion eshte 3 minuta

Kur peshorja eshte ne gjendje gjumi , prisni nje +7 minuta vonese nga koha e caktuar e mesazhit (nese mesazhi pritet ne oren 22:00 ai do te arrije te ju ne oren 22:07)

Kur pesha ne peshore eshte zero, mesazhi qe do te merrni do te shfaqi tekstin si me poshte:

“N/A” (Not Available) – (e padisponueshme)

Voltazhi i brendshem i baterise (BAT)

Ketu ju mund te kontrolloni nivelin e baterise ne peshore. Kur bateria eshte e karrikuar plotesisht eshte afersisht 4.1V-4.3V dhe kur bateria eshte thuajse e mbaruar eshte perfaresisht 3.6 V(niveli i sigurise)

Nese niveli i baterise bie nen 3.6V atehere peshorja do te keqfunksionoje dhe do te rriten shanset qe pajisja te fiket totalisht. Nese kjo ndodh, atehere nje rivenie ne pune manualisht kerkohet (nga celesi i pajisjes)

Ne kete rast, komanda **1234 RESET**nuk funksionon.

Kur niveli i baterise eshte nen “nivelin e sigurise” ne fund te mesazhit informues do te jte i shkruar treguesi “LOW BAT”

Paneli diellor

Nese keni nje burim energjie konstant ne zgjua, atehere sugjerohet te merrni energja aty per te lidhur pajisjen tuaj .

Nese jo , nje panel diellor eshte nje zgjedhje e shkelqyer thjesht sese mbulon nvojat per energji te peshores. Ne muajt e veres (mars deri ne shtator) nga nivelet e larta te eksoopozimit ne diell peshoret qe jane te pajisura me nje panel diellor jane ne perdonim dhe fuksionim te plete. (sleep off)

Ne muajt e dimrit eshte me mire ta vendosni peshoren ne gjendje gjumi SLEEP ON.

Autonomia e gjumit ne gjendjen SLEEP ON eshte per gjithe kohen

Per te aktivizuar gjendjen SLEEP ON shkruani mesazhin me tekst :

1234 SET AUTOSLEEP ON

Alarm – Tamper1, Tamper 2

Kjo pajisje ofron alarme 2 zonesh, Tamper 1 (kontaktet e kuqe) dhe Tamper2 (kontaktet e zesa)

Per te aktivizuar/caktivizuar Tamper1/ Tamper 2 thjesht shkruani ne mesazh tekstin e meposhtem:

1234 SET TAMPER1 ON-OFF

1234 SET TAMPER2 ON-OFF

Si te lidhim alarmet:

Lidh nje kabell njesh nga kontakti i kuq (Tamper 1) dhe rretho zonen e mbajtjes se bleteve permes celesave te hojezave (qelizave). Pastaj kthehu dhe lidhe kabllin ne kontaktin e dyte te kuq. Rradha e kabllove eshte e parendesishme.

Frekuencia e alarmeve eshte e vendosur cdo 24 ore.

Neqoftese peshorja eshte ne gjendje gjumi, alarmi nuk eshhete lehtesish i disponueshme. Ne rast dhunimi, pajisja do tju njoftoje ne oren e ardhshme te percaktuar te marrjes se mesazheve "smshour".

Vendodhja e pajisjes (zona gjeografike)

Zona gjeografike ofron survejim te peshores suaj. Nese peshorja juaj levizet nga rrezja e gjendjes aktuale, pajisja do tju telefonoje (therrase) dhe do tju dergoje ju një mesazhe alarmi me koordinatat e Google Earth

Gjendja e ketij parametri fillimisht eshte :**OFF**

Per te aktivizuar ose caktivizuar kete parameter dergoni mesazhin me tekstin e meposhtem:

1234 SET GEOFENCE ON (per aktivizim)

Ose

1234 SET GEOFENCE OFF (per caktivizim)

Per te caktuar rrezen per survejim, dergo komanden e meposhtme me rrezen e preferuar (ne metra). Per shembull ne do te perdorim komanden 1000 m per rrezen e preferuar .

1234 SET GEORADIUS 1000

Kujdes : nese ju ndryshoni vendodhjen ju duhet te ristartoni,riveni ne pune pajisjen ,keshtu qe vendodhja e re do te kycet per survejim.

** Supervizimi nuk eshte i disponueshem kur peshorja eshte ne gjendje gjumi.*

Sirena

Pajisja ofron opzionin te lidhjes se saj me nje sirene te jashtme.

Pasi bleni nje sirene ju keni nevoje te lidhni nje linje energjie ne seri me kontaktit dales. Kjo dalje sherben si celes.

Nese prodhuesi i ju jep me bashke me pajisjen nje sirene, atehere lidheni ne prizen dalese sipas ,(-) **negative= black** & (+) **positive = red**

Kohezgjatja e renies se sirenesh eshte 60 sekonda.

Cdo here qe ju riveni, ristartoni pajisje, ndodh nje tes alarmi qe do te tingelloje per 10 sekonda.

**kur pajisja eshte ne gjendje gjmi sirena nuk eshte e disponueshme ne gadishmeri.
Nese ndonje dhunim ndodh ne cdo kohe atehere sirena do te aktivizohet ne oren e ardshme te percaktuar per marrje mesazhesh “smshours”.*

Fence

Per te aktivizuar fence, dergojme mesazhin me tekstin e meposhtem

1234 SET FENCE ON

Eshte e rendesishme te percaktojme minimumin e voltazhit qe ruan fence.

Per te bere kete , dergojme komanden e meposhtme ne volts (psh. 5000 volt)

1234 LOWLIMIT 5000

- *Survejimi i Fence nuk eshte i disponueshem nese peshorja eshte ne gjendje gjumi*

Sinjali Gsm (sinjali i kompanise telefonike) & antena e jashtme (Extra)

Sinjali GSM i peshores duhet te jete mbi 30% ne menyre qe te dergohen mesazhet me sukses.

Nese ju e keni pajisjen me antenen e jashtme, per marrje me te mire poziciononi antenen sa me lart te jete e mundur. Antena e jashtme fiton +7dbi marrje krahasuar me antena e brendshme qe eshte +3dbi.

Shtimi , fitimi ne focen e sinjalit mund mos te jete aq i madh, por avantazhi kryesor eshte se antena e jashtme ofron, eshte shkatthesia e levizjes se saj rrotull zgjoit dhe pozicionimi i saj sa me lart per marrje me te mire GSM.

Ne rastin e deshtimit te dergimit te tekstit (si pasoje e kualitetit te keq te sinjalit), pajisja mund te mbaje deri ne 4 mesazhe. Keto mesazhe do te dergohen ne oren e rrades te percaktuar nese kualiteti i sinjalit eshte me i mire.

Nese probleme lidhjeje vazhdojne te ndodhin, edhe pse me antene te jashtme, provoni te ndryshoni kompanine telefonike qe keni .

Nje keshille e mire per te gjetur vendndodhjen me sinjalin me te mire eshte te ecni rreth zgjoit me telefon dhe te kontrolloni ku eshte sinjali me i forte. Aty ju duhet te vendosni peshoren.

Ne rast se nje mesazh i programuar nuk vjen ne kohe , ju lutemi te jeni te duruar dhe te prisni per mesazhin tjeter te paracaktuar. Ndonjehere, si pasoje e kushteve te ashpra atmosferike ose faktoreve te perkohshem te jashtem, kualiteti i sinjalit mund te jete i dobet.

Karrikimi i baterise

Ju mund ta karrikoni baterine me pajisjen e energjise qe jeni pajisur.

Per peshore te cilat jane blere pas dates 15/6/2018 eshte nje drite karrikim (CHG) jashte kutise, ne te djathte ne krah te celsit. Karrikimi ka perfunduar kur drita eshte e fikur .

Autonomia në modalitetin Sleep me 3 sms / ditë është mbi 12 muaj. Nëse modaliteti i gjumit është i çaktivizuar, autonomia është 3-5 ditë.

LEDS

Pajisja ka 3 drita LED, nje ne karten meme dhe dy jashte kutise.

Drita ne karten meme tregon statusin e sinjalit GSM (drite jeshile)

Kur drita vezullon 2 here ne sekonde do te thote se pajisja po kerkon per rrjet.

Kur drita vezullon 1 here cdo dy sekonda, do te thote qe pajisja nje kycur ne nje rrjet.

Drita e kuqe jashte kutise , afer hyrjes se energjise, tregon prezencen e voltazhit te jashtem ne pajisje.

Drita “CHG” tregon statusin e karrikimit. Kur ehste e ndezur, do te thote qe po karrikohet, kur fiket do te thote qe karrikimi ka perfunduar.

Ruajtja (paketimi) e pajisjes

Per ruajtjen e pajisjes sigurohuni qe eshte e karrikuar plotesisht dhe celesi eshte i shtypur ne pozicionin off (pika e kuqe) keshtu qe do jetë gati per perdorimin e rradhes.

Lista finale e kontrollit – shenime

1. Sigurohuni qe pajisja eshte e karrikuar plotesisht nese drita Led e karrikimit (CHG) eshte e fikur
2. Kontrolloni nese ushqyesit e energjise jane te lidhura si duhet
3. Celesi eshte ne pozicionin ON (pika jeshile)
4. Voltazhi i baterise se brendshme eshte mbi 3.9 volt
5. Sigurohuni qe sinjali i GSM eshte > 30% dhe se ju keni blere njje pakete me sms (oferte) nga kompania telefonike.
6. Sigurohuni qe te merrni te paketn një mesazh raportimi nga pajisja me peshe, temperature etj perpara se te largoheni nga zgjoi.
7. Kontrolloni nese pesha eshte korrekte (perafersisht)
8. Kontrolloni te shikoni nese keni marre mesazh qe konfirmon se sinkronizimi i ores ishte i suksesshem, nese jo (ne rast sinjali te keq GPS) duhet ta beni manualisht
Per ta bere kete , shkruani mesazhin me tekst : **1234 SET DATE 01/01/17#01:05**
9. Ne rast keqfunkcionimi , rekomandohet te ristartohet peshorja duke perdorur celesin (nese jeni nezgjua) ose ta risetoni nepermjet tekstit (1234 RESET)
10. Paneli diellor ka nevoje te jetë me fytyre nga veriu dhe te jetë ne një kend prej 35° gradesh. Sigurohuni qe paneli diellor eshte ne kontakt direkt me driten e diellit dhe jo nen hije.
- 11.** Kur perdorni pajisjen me panel diellor, rekomandohet qe ju ta vendosni pajisjen ne gjendje gjumi automatikisht **AutoSleep** e aktivizuar(**ON**).

Shpjegimi i tingujve nga pajisja :

- *Bip i shkurter*
- bip i gjate*
- *venie ne pune e pajisjes*
- *kycje e rrjetit GSM*
- *Kompozimi i mesazheve te raportimit*
 - ore – date sinkronizim*
 - kycja e vendodhjes (zones gjeografike)*
 - mesazhi eshte derguar me sukses*
 - deshtoi dergimi i mesazhit (nuk ka kredit te mjaftueshem)*
 - futet ne gjendjen Sleep/ Autosleep*

Shenime

Kontakte



<http://www.melissozigaria.gr>



info@melissozigaria.gr



+30 26513 11500



Technical Support: 09:00-20:00 6947800927



www.facebook.com/Melissozygaria